



04 Nr. 451-20581/19

Data: 24/05/2019

Në bazë të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Klinës, miratuar nga Kuvendi Komunal, me nr.01 Nr. 06-2733/ 2016 të datës 1.06.2016, si dhe bazuar në vendimin numër 01 Nr.451-20362/2019 të datës 22.05.2019 të Kryetarit të Komunës së Klinës z. Zenun Elezaj për anulim të konkursit për bursa të studentëve, Drejtoria e Arsimit në Klinë rishpall :

K O N K U R S

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KLINËS

- I. Sipas këtij konkursi ndahen 20 (njëzet) bursa për studentë të dalluar të Komunës së Klinës për vitin akademik 2018/2019.

II. KUSHTET DHE KRITERET E APLIKIMIT

Për fitimin e bursave të studimeve kanë të drejtë të konkurrojnë kandidatët që i plotësojnë kushtet si në vijim:

- 1.1 Të jenë studentë të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës, por jo edhe ata me vetëfinancim, korrespondencë, studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoranturë;
- 1.1 Të jenë studentë të rregullt, të vitit të 2-të e më lart;
- 1.2. Të jenë banorë të përhershëm të Komunës së Klinës;
- 1.3 Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
- 1.4 Të jenë studentë që nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër nga buxheti i Kosovës si dhe të mos jenë të punësuar në institucione publike;
- 1.5 Të mos jenë përsëritës të vitit.
- 1.6 Të kenë notën mesatare 7.5 e më të lart, përveç studentëve të profileve deficitare, si në pikën 1.7 të këtij neni;
- 1.7 Përparësi në fitimin e së drejtës për bursë do të kenë studentët që studiojnë në lëmënjtë deficitare (Fakulteti i Mjekësisë-Drejtimi i Përgjithshëm, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë-profil i Arsimit dhe Drejtimi Fizikë-profil i arsimit).

III. KRITERET DHE PËRPARËSITË E PËRFITIMIT TË BURSËS

1. Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak, kandidati vlerësohet me pikë si në vijim:
 - 1.4 Poentimi vlerësohet me po aq pikë sa është nota mesatare e studentit.
2. Përparësi në start kanë profilet deficitare si nga pika 1.7 e nenit 6 të Rregullores, do të poentohen me 5 pikë bonus;
3. Studentët nga e njëjta familje vlerësohen me 2 pikë.
4. Studenti me aftësi të kufizuar vlerësohet me 2 pikë.

5. Studenti, i cili nuk e ka asnjërin prind vlerësohet me 1 pikë;

IV. Rastet e pozitës së barabartë;

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura me lart, do të kenë përparësi:

- 1) studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve dhe të invalidëve të luftës,
- 2) Studentët me aftësi të kufizuar,
- 3) Studentët e gjinisë femërore,

V. Studentët e së njëjtës familje:

1. Prej një familjeje mund të marrë bursë vetëm një student.
2. Nga studentët që i takojnë së njëjtës familje e që i plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës, do ta përfitojë bursën studenti që ka notën mesatare më të lartë.

Nëse përfituesi i bursës ndërron fakultetin, humb të drejtën e shfrytëzimit të bursës. Studenti detyrohet ta kthejë bursën, nëse konstatohet se merr bursë nga ndonjë njësi tjetër buxhetore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim (të gjitha origjinale):

- Certifikata e notave
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm
- Kopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë, vëlla, motër e dëshmorit
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike në emër të prindit e cila merret në Drejtorin e Financave.
- Vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2018
- Vërtetimin se studenti ka regjistruar vitin akademik 2018/2019 si student i rregullt.

Vërejtje: bursat do të ndahen vetëm për studentë që kanë mbaruar vitin e parë të studimeve dhe më lart.

Bursat ndahen për afatin kohor: 01.10.2018 deri më 31.07.2019 (dhjetë muaj), me vlerë 50 €.

Kundër vendimit për shpalljen e listës së përfituesve të bursave nga komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet komisionit të ankesave, i formuar “ad hoc” me vendim të Kuvendit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.

SQARIM: Dokumentacioni i dorëzuar në Drejtorin e Arsimit sipas konkursit të anuluar me numër 04 Nr. 451-8285/18 të datës 10.12.2018, është i vlefshëm edhe për këtë konkurs, por studentët që kanë aplikuar duhet të plotësojnë aplikacionin e ri dhe ta drejtojnë në DKA si dhe ndonjë dokument shtesë që është në interes të tyre, brenda afatit të konkurrimit dhe brenda orarit zyrtar të punës.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet në DKA dhe të plotësuara bashkë me dokumentacionin tjetër t'i dorëzojnë në Drejtorinë e Arsimit në Klinë gjatë orarit zyrtar të punës (8:00- 16:00)

Drejtori
Arben Limanaj

